



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto produkti vendor në qasjen e shpenzimevet (2008-2013)



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto produkti vendor në qasjen e shpenzimevet (2008-2013)



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Shtator, 2014

© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përpiluar të dhënat preliminare të Bruto Produktit Vendor (BPV) për vitet 2008-2013, me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante. BPV është përlogaritur në bazë të parimeve metodologjike të Sistemit Evropian të Llogarive ("European System of Accounts" - ESA 2010) dhe "System of National Accounts" - SNA 2008.

Të dhënat nga Llogaritë Kombëtare përdoren për planifikim ekonomik dhe fiskal dhe për elaborimin e programeve të zhvillimit për sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Rezultatet nga llogaritë kombëtare përdoren po ashtu nga investitorët e vendit dhe të huaj, për të vlerësuar situatën ekonomike të shtetit dhe mundësitë për investime të reja.

ASK do të vazhdojë zhvillimin e Llogarive Kombëtare në pajtim me rekomandimet ndërkombëtare dhe do të publikojë të dhëna kualitative dhe me kohë.

Falënderojmë veçmas ekspertin e FMN-së.

Publikimin e përgatitën:

Ilir T. Berisha-drejtor i departamentit
Xhevrie Fetahu-shefe e divizionit
Ylli Shala-zyrtar i lartë
Ilir Mazrekaj-zyrtar i lartë
Emine Bajrami-zyrtare e lartë
Florije Krapci-zyrtare e lartë
Nysret Sylejmani - zyrtar i lartë
Besim Mehmeti- zyrtar i lartë

Prishtinë, Shtator 2014

Kryeshef Ekzekutiv i ASK,
Z. Isa Krasniqi

Lista e shkurtesave

BoPs	Bilanci i Pagesave
SHKF	Shpenzimet e Kapitalit Fiks
CIF	Kostoja, Sigurimi, Ngarkesat
CIOCOP	Klasifikimi i Konsumit Individual të Ekonomive Shtëpiake sipas Qëllimit
COFOG	Klasifikimi i Funksioneve të Qeverisë
EAA	Llogaritë Ekonomike të Bujqësisë
ESA 2010	Sistemi i Llogarive Evropiane 2010
FISIM	Shërbimet e ndërmjetësimit financiar të matura në mënyrë indirekte
FOB	I liruar nga shpenzimet e transportit
BPV	Bruto Produkti Vendor
FBKF	Formimi i Bruto Kapitalit Fiks
BVSH	Bruto Vlera e Shtuar
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
SHKFEF	Shpenzimet e Konsumit Final të Ekonomive Familjare
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
NACE rev.1	Nomenklatura e Klasifikimit të Aktiviteteve Ekonomike
NPISH	Organizatat jo-fitimprurëse që iu shërbejnë ekonomive familjare
PIM	Metoda PIM
SNA	Sistemi i Llogarive Kombëtare
SUT	Tabela Ofruese - Përdoruese

P a r a t h ë n i e

	Faqe
Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve 2008-2013	4
Tabela 1: Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale 2008-2013.....	4
Graf. 1.1. BPV për kokë banori.....	5
Tabela 2: Struktura e BPV sipas shpenzimeve.....	6
Graf. 2.1 Pjesëmarrja e komponentëve në BPV 2010-2013.....	7
Tabela 3: BPV me çmime konstante (me çmimet e vitit paraprak)	8
Graf. 3.1 Norma reale e rritjes së Bruto Produktit Vendor 2008-2013.....	9
Shënime metodologjike	10
Pjesët përbërëse të Bruto Produktit Vendor.....	10
1. Konsumi final i ekonomive shtëpiake.....	10
2. Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë së Përgjithshme	11
3. Formimi i bruto kapitalit.....	11
4. Konsumi final i institucioneve jo profitabile të cilat i'u shërbejnë ekonomive shtëpiake	11
5. Importi dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve.....	11

Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve 2008-2013

Treguesi kryesor dhe më i rëndësishëm makroekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili paraqet rezultatet finale të prodhimit në të gjitha aktivitetët e njësive prodhuese rezidente.


Kalkulimi i Bruto Produktit Vendor bazohet në metodologjinë e SNA 2008 dhe ESA 2010 dhe shrytëzon burimet e të dhënave administrative ekzistuese si dhe anketat statistikore zyrtare, të cilat realizohen në ASK.

Tabela 1: Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale 2008-2013

	(në milion Euro)					
	2008	2009	2010	2011	2012	2013
BPV me çmime aktuale	3,882.8	4,069.6	4,402.0	4,814.5	5,058.7	5,326.6
Shpenzimet e konsumit final	4,172.2	4,221.6	4,516.5	4,975.5	5,320.4	5,539.3
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	3,488.9	3,528.5	3,768.2	4,142.3	4,458.1	4,652.4
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	659.8	668.1	722.3	802.1	842.1	863.9
Qeveria e Kosovës	358.0	407.2	495.7	578.4	625.0	658.8
Donatorët (pagat)	301.8	260.8	226.6	223.7	217.1	205.2
Të punësuar të huaj	196.9	178.7	157.4	155.5	150.9	142.6
Të punësuar vendor	104.9	82.1	69.2	68.2	66.2	62.6
Shpenzimet e konsumit final të JPSHESH	23.6	25.0	26.0	31.1	20.2	23.0
Formimi i bruto kapitalit	1,208.7	1,267.4	1,450.6	1,632.4	1,465.1	1,470.9
Formimi i bruto kapitalit fiks	1,052.7	1,129.8	1,301.2	1,475.9	1,316.8	1,322.6
Ndryshimet në inventar	156.0	137.6	149.4	156.5	148.3	148.3
Eksporti neto	-1,498.2	-1,419.4	-1,565.2	-1,793.3	-1,726.8	-1,683.6
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	608.9	694.9	878.0	943.4	922.1	927.1
Eksporti i mallrave	216.6	177.2	305.0	324.9	287.0	305.1
Eksporti i shërbimeve	392.4	517.6	573.0	618.5	635.1	622.0
Importi i mallrave dhe shërbimeve	2,107.1	2,114.2	2,443.1	2,736.7	2,648.8	2,610.7
Importi i mallrave (FOB)	1,866.3	1,828.9	2,057.1	2,383.9	2,360.0	2,297.1
Importi i shërbimeve	240.8	285.3	386.1	352.8	288.8	313.7
BPV për kokë banori (Euro)	2,258	2,329	2,480	2,672	2,799	2,935

BPV në Kosovë për vitet 2008-2013 është rritur në vlerën prej 3,882.8 në 5,326.6 milion euro. BPV për kokë¹ banori është rritur prej 2,258 euro në vitin 2008 , në 2,935 euro në vitin 2013.

Graf. 1.1. BPV për kokë banori



Siç shihet nga grafi, BPV për kokë banori kishte trend rritës, duke arritur në 2,935 euro për vitin 2013.


¹ Kalkulimet e numrit të popullsisë për vitin 2013 janë të dhëna paraprake.

Tabela 2: Struktura e BPV sipas shpenzimeve

	2008	2009	2010	2011	2012	2013
BPV me çmime aktuale	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Shpenzimet e konsumit final	107.5	103.7	102.6	103.3	105.2	104.0
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	89.9	86.7	85.6	86.0	88.1	87.3
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	17.0	16.4	16.4	16.7	16.6	16.2
Qeveria e Kosovës	9.2	10.0	11.3	12.0	12.4	12.4
Donatorët (pagat)	7.8	6.4	5.1	4.6	4.3	3.9
Të punësuar të huaj	5.1	4.4	3.6	3.2	3.0	2.7
Të punësuar vendor	2.7	2.0	1.6	1.4	1.3	1.2
Shpenzimet e konsumit final të JPSHESH	0.6	0.6	0.6	0.6	0.4	0.4
Formimi i bruto kapitalit	31.1	31.1	33.0	33.9	29.0	27.6
Formimi i bruto kapitalit fiks	27.1	27.8	29.6	30.7	26.0	24.8
Ndryshimet në inventar	4.0	3.4	3.4	3.2	2.9	2.8
Eksporti neto	-38.6	-34.9	-35.6	-37.2	-34.1	-31.6
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	15.7	17.1	19.9	19.6	18.2	17.4
Eksporti i mallrave	5.6	4.4	6.9	6.7	5.7	5.7
Eksporti i shërbimeve	10.1	12.7	13.0	12.8	12.6	11.7
Importi i mallrave dhe shërbimeve	54.3	52.0	55.5	56.8	52.4	49.0
Importi i mallrave (FOB)	48.1	44.9	46.7	49.5	46.7	43.1
Importi i shërbimeve	6.2	7.0	8.8	7.3	5.7	5.9

Konsumi Final i ekonomive shtëpiake merr pjesë me 87.3 për qind në BPV për vitin 2013, deri sa në vitin 2012 kishtë një pjesëmarrje prej 88.1 për qind të BPV-së. Formimi i bruto kapitalit ka kontribuar me 27.6 për qind në BPV në vitin 2013. Shpenzimet e konsumit final të qeverisë në 2013 kanë përfaqësuar 16.2 për qind të BPV-së.

Graf. 2.1 Pjesëmarrja e komponentëve në BPV 2010-2013



Siç shihet nga grafiku, në vitin 2013 kishte ndryshime strukturore të pjesëmarrjes së komponentëve kryesore në BPV krahasuar me vitin 2012:

- Konsumi Final i Ekonomive Shtëpiake (KFESH) nga 88.1 për qind të BPV në vitin 2012 në 87.3 për qind në vitin 2013;
- Konsumi Final i Qeverisë (KFQ) nga 16.6 për qind të BPV në vitin 2012 në 16.2 për qind në vitin 2013;
- Formimi i Kapitalit Bruto (FBK) nga 29.0 për qind të BPV në vitin 2012 në 27.6 për qind në vitin 2013;
- Eksporti Neto nga – 34.1 për qind të BPV në vitin 2012 në – 31.6 për qind në vitin 2013.


Tabela 3: BPV me çmime konstante (me çmimet e vitit paraprak)

(në milion Euro)

	2008	2009	2010	2011	2012	2013
BPV me çmime konstante	3,616.1	4,022.4	4,204.3	4,594.6	4,949.9	5,232.8
Shpenzimet e konsumit final	3,912.8	4,218.2	4,325.1	4,652.0	5,104.3	5,437.8
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	3,268.9	3,569.3	3,651.5	3,900.3	4,264.3	4,548.3
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	620.8	624.3	648.4	722.8	820.0	869.6
Qeveria e Kosovës	323.5	367.4	429.5	506.6	605.1	649.6
Donatorët (pagat)	297.3	257.0	218.9	216.2	214.9	220.1
Shpenzimet e konsumit final të JPSHESH	23.1	24.5	25.1	29.0	20.0	19.9
Formimi i bruto kapitalit	1,123.7	1,340.3	1,405.0	1,565.0	1,422.3	1,460.2
Formimi i bruto kapitalit fiks	979.9	1,194.7	1,254.2	1,407.1	1,274.7	1,314.1
Ndryshimet në inventar	143.8	145.6	150.8	157.9	147.6	146.1
Eksporti neto	-1,420.4	-1,536.0	-1,525.8	-1,622.4	-1,576.7	-1,665.2
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	547.1	683.9	781.5	907.0	948.4	944.7
Eksporti i mallrave	188.3	193.2	227.9	309.4	320.8	323.8
Eksporti i shërbimeve	358.8	490.6	553.6	597.6	627.5	620.9
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1,967.5	2,219.9	2,307.3	2,529.3	2,525.1	2,609.9
Importi i mallrave (FOB)	1,734.4	1,935.5	1,927.3	2,180.8	2,239.1	2,291.9
Importi i shërbimeve	233.1	284.4	380.0	348.6	286.0	318.0
BPV - Norma reale e rritjes	4.5	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4

Norma reale e rritjes së Bruto Produktit Vendor (BPV) në Kosovë ishte 3.4 për qind në vitin 2013.

Graf. 3.1 Norma reale e rritjes së Bruto Produktit Vendor 2008-2013



Shënime metodologjike

Bruto Produkti Vendor llogaritet sipas tri qasjeve:

- Qasja e prodhimit
- Qasja e shpenzimeve dhe
- Qasja e të ardhurave

Qasja e shpenzimeve:

Bruto produkti vendor (BPV) sipas qasjes së shpenzimeve është shuma e të gjitha shpenzimeve finale të mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime ndahen në tri grupe kryesore : konsumi final, formimi i kapitalit bruto dhe neto eksporti dhe importi (E-I). Meqë bruto prodhimi vendor (BPV) matë prodhimin e brendshëm, vlera e të gjitha shpenzimeve të importit zbritet nga të gjitha shpenzimet duke përdorë formulën:

$$BPV = KF + FKB + (E-I)$$

KF = konsumi final

FKB = formimi i kapitalit bruto

E = eksporti

I = importi

Pjesët përbërëse të Bruto Produktit Vendor

1. Konsumi final i ekonomive shtëpiake

Konsumi final i ekonomive shtëpiake është komponenti kryesor i Bruto Produktit Vendor me qasjen e shpenzimeve dhe paraqet shpenzimet e ekonomive shtëpiake rezidente, me qëllim të plotësimit të nevojave dhe kërkesave të tyre për mallra dhe shërbime. Kjo nuk nënkupton vetëm mallrat dhe shërbimet e paguara direkt, por gjithashtu edhe marrjen e tyre edhe në natyrë ose nga prodhimi vetanak.

Vlerësimi i shpenzimeve të ekonomive shtëpiake është bazuar në të dhënat e anketës së buxhetit të ekonomive shtëpiake. Kjo anketë organizohet në ASK.

2. Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë së Përgjithshme

Konsumi final i Qeverisë përbëhet nga shuma e mallrave dhe shërbimeve të blera, kompensimi i punëtorëve dhe konsumit të kapitalit fiks, i zvogëluar për të hyrat nga shitjet.

3. Formimi i bruto kapitalit

Bazuar në metodologjinë e ESA 95, formimi i bruto kapitalit paraqet shumën e formimit të bruto kapitalit fiks dhe ndryshimeve në inventar.

Vlerësimi i formimit të bruto kapitalit fiks përfshinë posedimin e të gjitha aseteve të prekshme dhe përmirësimet kryesore në asete të prekshme të cilat përdoren më shumë se një vit. Vlerësimet e FBKF përfshijnë këto lloje të aseteve: banesat, ndërtësat tjera dhe strukturën, makinerinë dhe pajisjet.

Burimi kryesor i të dhënave për investime janë të dhënat nga importi për makineri dhe pajisje. Këto të dhëna po ashtu plotësohen me të dhëna nga prodhimi vendor i materialit ndërtimor.

Ndryshimet në inventar maten me vlerën e hyrjes së mallit në inventar, të zvogëluar për vlerën e tërheqjes dhe të ndonjë dëmi të shkaktuar në atë mall gjatë mbajtjes së tij në inventar. Vlerësimi i ndryshimeve në inventar është bazuar në rezultatet e Anketës strukturore të ndërmarrjeve, e realizuar nga ASK.

4. Konsumi final i institucioneve jo profitabile të cilat i'u shërbejnë ekonomive shtëpiake

Institucionet jo profitabile të cilat i'u shërbejnë ekonomive shtëpiake përbëhen nga organizatat jo qeveritare(OJQ).

5. Importi dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve përfshinë transaksionet e mallrave dhe shërbimeve nga rezidentët tek jo rezidentët.

Importi i mallrave dhe shërbimeve përfshinë transaksionet e mallrave dhe shërbimeve nga jo rezidentët tek rezidentët.

Të dhënat e eksportit dhe importit të mallrave janë marrë nga Dogana e Kosovës, ndërsa të dhënat e eksportit dhe importit të shërbimeve janë marrë nga Bilanci i pagesave (BOP), i elaboruar në Bankën Qendrore të Kosovës(BQK).

Burimet e të dhënave

a) Burimet statistikore të të dhënave

- Rezultatet e anketave të kryera nga ASK, si: anketa e buxhetit të ekonomive shtëpiake, anketa e fuqisë punëtore, anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore dhe publikimet e ndryshme të ASK;
- Të dhënat e tregtisë së jashtme : importi dhe eksporti i mallrave;
- Indeksi i çmimeve të konsumit, indeksi i çmimeve të importit, indeksi i çmimeve të prodhimit dhe indekset tjerë të çmimeve të përlogaritur nga ASK;
- Rezultatet përfundimtare të regjistrimit të popullsisë 2011

b) Burimet administrative:

- Ministria e Financave, të dhënat e buxhetit dhe të thesarit;
- Banka Qendrore e Kosovës, të dhënat e Bilancit të pagesave dhe të dhënave tjera;
- Ministria e Administratës Publike për të dhënat e OJQ-ve;
- Ministria e Bujqësisë për disa të dhëna të bujqësisë;
- Administrata tatimore e Kosovës –të dhënat për tatimet

Rishikimet e BPV-së vjetore me qasjen e shpenzimeve

BPV sipas qasjes së shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante për periudhën 2008-2012 është rishikuar kryesisht për shkak të zbatimit të sistemit të ri të llogarive kombëtare ESA 2010, burimeve të reja të të dhënave (regjistrimit të popullsisë i kryer në vitin 2011, zhvillimit të Llogarive Ekonomike Bujqësore, bilancit të rishikuar të pagesave (BoP), të dhënave më të detajuara për shpenzimet kapitale të qeverisë dhe përmirësimit të metodave të përpilimit të cilat mundësojnë aplikimin e metodës (PIM), dhe zgjerimin e burimeve të të dhënave administrative të përdorura.

Rishikimet e të dhënave për vitet 2008-2012 për shkak të zbatimit të ESA2010 përfshijnë: (i) vlerësimet e reja për kërkime dhe zhvillime dhe sistemin e armatimit dhe këto përfshihen në formimin e bruto kapitalit fikse (FBKF); (ii) vlerësimet e reja të FISIM me çmime aktuale dhe konstante dhe shpërndarjen e tyre për përdoruesit; (iii) vlerësimin e outputit të Bankës Qendrore.

Burimet e reja të të dhënave mundësojnë vlerësimin e qirasë së përlogaritur duke u bazuar në qasjen e kostos përdoruese dhe përmirësimin e FBKF me përfshirjen edhe të burimeve të kultivuara biologjike (shtazëve dhe plantacionin), ashtu siç e kërkon metodologjia e llogarive kombëtare.

Pikat kryesore të rishikimeve të të BPV me qasjen e shpenzimeve janë përmbledhë si vijon:

a. Për vlerësimin e Konsumi Final të ekonomive familjare

Metoda e rrjedhës së mallit është elaboruar nga të dhënat e tabelave ofruese-përdoruese dhe është aplikuar sistematikisht për të gjitha grupet e konsumit

individual sipas qëllimit (COICOP). Për të vlerësuar prodhimin vendor të mallrave dhe shërbimeve të konsumuara nga ekonomitë familjare, janë përdorë të dhënat e outputit nga anketa strukturore e ndërmarrjeve në nivelin 4 shifror të Klasifikimit sipas Aktiviteteve Ekonomike (NACE, Rev.1). Tabela korresponduese në mes të NACE Rev.1, klasifikimit të produkteve sipas aktiviteteve të vitit 2002 dhe më pas COICOP-it të vitit 1999, janë rishikuar dhe përditësuar në bazë të tabelave korresponduese të Eurostat-it. E njëjta procedurë është aplikuar për të azhurnuar të dhënat në nivel 6 shifror të tregtisë së jashtme në baze të sistemit të harmonizuar HS2007 në klasifikimin e COICOP. Qasja sipas rrjedhës së produktit u zhvillua më tej duke shtuar eksportet dhe konsumin e ndërmjetëm të mallrave, dhe duke aplikuar rregullime në bazë të tatimit aktual. Barazimi i KFEF me të dhënat e anketës së buxhetit familjar u përmirësua me tej. Qiraja e re e përlogaritur dhe FISIM janë përfshirë në konsumin final të ekonomive familjare me çmime aktuale dhe konstante.

b. Konsumi final i qeverisë për vitet 2008-2012 është rishikuar për shkak të zbatimit të metodës së për vlerësimin e konsumit të kapitali fiks. Zhvillimi i metodës (PIM) për vlerësimin e konsumit të kapitali fiks u bë e mundur për shkak të të dhënave më të detajuara historike mbi asetet qeveritare të marra nga Ministria e Financave. Kalkulimet janë bërë për 20 grupe të aseteve fikse të qeverisë. Aplikimi i amortizimit vjetor gjeometrik u prezantua. Për të llogaritur konsumin e kapitali fiks me çmime aktuale, është kryer reflektimi duke përdorur indekset përkatëse të çmimeve për stoqe dhe rrjedha.

FISIM me çmime aktuale dhe konstante të alokuara për qeverinë është shtuar në keto vlerësime. Vlerësimet me çmime konstante të qeverisë së përgjithshme janë rishikuar, duke përmirësuar llogaritjen e konsumit të ndërmjetëm -indekset e çmimeve janë aplikuar në strukturën e detajuar të konsumit të ndërmjetëm (në total, rreth 70 kategori).

c. Vlerësimet me çmime aktuale dhe konstante të formimit të bruto kapitalit fiks (FBKF) janë rishikuar. Vlerësimet e bazuara në prodhimin vendor të materialeve të ndërtimit janë rishikuar pas rishikimit të Divizionit 26 dhe 14 të NACE. FBKF në plantacione dhe blegtori, kërkime dhe zhvillim dhe sistemin e armatimit janë shtuar në këto vlerësime. Vlerësimet për riparimet e mëdha në makineri dhe pajisje janë realizuar dhe integruar në këta tregues.

d. Vlerësimet e rishikuara të bilancit të pagesave janë përfshirë në importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve.

Mospërputhjet statistikore ndërmjet BPV-së vjetore me qasjen e prodhimit dhe BPV-së vjetore me atë të shpenzimeve nga seria e rishikuar për të gjitha 5 vitet nuk e kalojnë 3 për qind të BPV-së totale. Aktiviteti në rishikimin e të dhënave do të vazhdojë për të siguruar qëndrueshmërinë e serive kohore.

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. *Departamentet mbështetëse;* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyra për regjistrimin e popullsisë ekonomike familjare dhe banesave si dhe **Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë. Në vijim e sipër është përgatitja për Regjistrimin e Bujqësisë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni: +381 (0) 38 200 31 104**
Kryeshafi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail: economic@rks-gov.net**
- **Ueb-faqe: <http://ask.rks-gov.net>**